TË RËNËT BRITANIKË: TË VETMIT USHTARAKE TË HUAJ QË SHKELËN NË SHQIPËRI SI LIBERATORË

Mal BERISHA - studiues, ish ambasador i Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe

HYRJE

Në mëngjesin e datës **29 tetor 1944**, skuadra e Forcave Ajrore Mbretërore (RAF), me avionin **Halifax JP 244,148**, u nis nga Brindisi me një detyrë të posaçme për të dërguar furnizime në kuadër të **Operacioneve Ekzekutive Speciale (SOE)** drejt Shqipërisë. Destinacioni i avionit ishte zbarkimi i furnizimeve në pllajën e maleve të Çermenikës.

Pak pas ngritjes, lidhja me ekuipazhin u shkëput. Avioni mori flakë dhe u rrëzua, duke marrë me vete jetët e të gjithë anëtarëve të tij. Ata ishin:

- **Piloti Edwin John Stubley**,
- **Rreshteri Charles Mabbs**, farmacist,
- **Rreshteri Alfred Coote**, shofer,
- **Rreshteri John Thompson**, punonjës hekurudhash,
- **Rreshteri Ernest Logan Brown**, polic,
- **Rreshteri Austin Donnelly**, transportues qelqurinash,
- **Richard Charles Knee**, nënpunës.

Më 20 tetor 2021, në Memorialin e të Rënëve Britanikë, në Parkun e Tiranës, u zhvillua një ceremoni përkujtimore në nderim të rreshterit britanik Peter Twiddy.

ÇFARË ISHIN OPERATIVËT EKZEKUTIVË SPECIALË (SOE)?

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, pas rënies së Francës në duart e nazistëve, lindi nevoja e menjëhershme për krijimin e një force të posaçme britanike, e cila do të zhvillonte një luftë ndryshe kundër ushtrive hitleriane. Kjo forcë u pagëzua me emrin **Special Operations Executive (SOE)**.

Misioni i saj ishte të kryente akte spiunazhi dhe sabotazhi në prapavijat e nazistëve. Operativët e këtij formacioni kishin për detyrë të nxirrnin trenat nga shinat, të shembnin ura, të shkatërronin fabrika armësh dhe të pengonin linjat e furnizimit të armikut. Përveç këtyre veprimeve, ata ndihmonin në organizimin e luftës guerile në të gjitha vendet e pushtuara, duke

bashkëpunuar ngushtë me forcat vendore të rezistencës.

Më **16 korrik 1940**, Kryeministri britanik **Winston Churchill** emëroi **Hugh Dalton** si drejtues politik të SOE-së dhe i dha menjëherë urdhër të niste veprimtarinë në terren. Organizata përfshiu rreth **13.000 pjesëtarë**, prej të cilëve **3.200 ishin gra**.

SOE u shpërnda zyrtarisht më **15 janar 1946**, pasi misioni i saj ishte përfunduar me fitoren mbi nazizmin. Gjatë veprimtarisë së saj, agjentët e SOE kryen qindra aksione sabotazhi dhe spiunazhi. Një nga operacionet më të suksesshme ishte në **qershor 1941**, kur ata arritën të shpërthenin stacionin elektrik francez të **Pessac**.

Ky akt u prit në Londër si një sukses i madh dhe krijoi bindjen se nuk ishin vetëm bombat ato që do të shkatërronin makinën ushtarake gjermane. Ky operacion hapi rrugën për qindra aksione të tjera në gjithë Europën dhe deri në Lindjen e Largët, përfshirë edhe Japoninë.

Në vitin **1942**, një skuadër e SOE-së vrau me një granatë **Reinhard Heydrich**, njeriun e dytë më të fuqishëm të Rajhut dhe arkitektin e "Zgjidhjes Përfundimtare". Po atë vit, në **Greqi**, operativët e SOE-së shkatërruan **urën e Gorgopotamos**, duke i prerë furnizimet ushtrisë së **Romelit** në shkretëtirën afrikane. Ndërkohë, në **Norvegji**, ata shkatërruan një fabrikë të ujit të rëndë, duke i dhënë fund përpjekjeve naziste për të ndërtuar një **bombë atomike**.

SOE mund të godiste armikun **kudo dhe në çdo kohë**, duke u bërë një nga armët më të fuqishme të fshehta të aleatëve.

CILI ISHTE ROLI I SOE-SË NË SHQIPËRI?

Një nga aktet më të rëndësishme të ndërmarra nga Britania e Madhe ndaj Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore ishte përfshirja e vendit tonë në hartën e operacioneve të **Special Operations Executive (SOE)**.

Një numër i madh djemsh dhe vajzash britanikë, të trajnuar posaçërisht për veprime guerile, spiunazh dhe sabotazh, u dërguan në Shqipëri për t'u ballafaquar me një terren të ashpër malor dhe një situatë politike e

ushtarake krejtësisht të panjohur për ta. Ata mbështetën forcat e rezistencës shqiptare me furnizime, armë, këshilla ushtarake dhe koordinim me aleatët, duke e kthyer Shqipërinë në një pjesë të rëndësishme të frontit të fshehtë të aleatëve në Ballkan.

SOE, përveçse në vende të tjera si **Franca, Polonia, Gjermania, Hollanda, Belgjika, Italia, Jugosllavia, Hungaria, Greqia, Kreta, Çekosllovakia, Norvegjia, Danimarka, Rumania, Abisinia** dhe në **Azinë Juglindore**, veproi edhe në **Shqipëri**.

Një grup i vogël ndërlidhës i SOE-së hyri nga Greqia në Shqipëri në vitin **1943**. Mes agjentëve britanikë që vepruan në vendin tonë ishin: **Julian Amery, Anthony Quayle, David Smiley** dhe **Neil "Billy" McLean**.

Se si u zhvilluan operacionet e SOE-së në Shqipëri, na e ka përshkruar më së miri studiuesi britanik **Rodrick Bailey** në librin e tij: *"Provinca e Egër"*. Ky botim sjell me detaje veprimet, sfidat, konfliktet e brendshme dhe marrëdhëniet mes agjentëve britanikë dhe grupeve shqiptare të rezistencës.

SOE NË TOKËN E SHQIPEVE

Sipas studiuesit britanik **Roderick Bailey**, në vitin **1943** një ekip i vogël elitë i ushtarëve britanikë filloi të zbriste me parashutë në malet e Shqipërisë së pushtuar. Ata ishin pjesëtarë të **Special Operations Executive (SOE)** dhe kishin për mision të gjenin, të armatosnin dhe të mbështesnin çetat e luftëtarëve guerilas shqiptarë, si dhe të godisnin armikun sa më shumë që të ishte e mundur.

Këta oficerë dhe agjentë britanikë nuk kishin shkelur kurrë më parë në Shqipëri dhe nuk kishin asnjë ide se çfarë i priste në terrenin e egër malor, mes një popullsie të panjohur dhe një situate politike e ushtarake tepër të ndërlikuar.

TAKIM ME DR. RODERICK BAILEY, AUTOR I LIBRIT *“PROVINCA E EGËR”*, MË 14 SHKURT 2013, NË AMBASADËN SHQIPTARE NË LONDËR

Duke u përpjekur të mbijetonin në kushtet më ekstreme dhe në një terren tepër të vështirë, këta britanikë të rinj jetuan nën rrezikun e përhershëm se mos binin në duart e armikut, ku i priste vdekja e sigurt. Përveç sëmundjeve, mungesës së ushqimit dhe pamundësisë për të mbajtur një jetë normale e të pastër, atyre u shtohej edhe fakti se çetat guerile shqiptare ishin shpesh në konflikt me njëra-tjetrën.

Në këtë libër të jashtëzakonshëm, autori ka shfrytëzuar intervista me të mbijetuarit, ditare të mbajtura fshehur për dekada, si dhe dokumente të deklasifikuara së fundmi, të cilat dëshmojnë historinë dramatike dhe të jashtëzakonshme të veprimtarisë së **SOE-së në Shqipëri**.

Sipas dokumenteve të **SOE-së**, deri në vitin **1945** në Shqipëri u dërguan:

- **7.000 pushkë**
- **5.000 armë gjysmë-automatike**
- **1.800 mitraloza të lehtë**
- **60 mitraloza gjysmë të rëndë**
- **16.500.000 fishekë**
- **240 mortaja**
- **25.000 bomba**
- **25.000 granata**
- **një sasi e konsiderueshme pistoletash**

Përveç armatimit, u siguruan edhe materiale logjistike e ndihma jetike për çetat guerile shqiptare:

- **28.000 palë rroba ushtarake**
- **57.000 palë çizme ushtarake**
- **14.000 batanije**

- **390 fenerë**
- **6 xhipa**
- **1 motorbarkë**
- **qindra ton me ushqime dhe furnizime të tjera bazë.**

Këto të dhëna tregojnë qartë shkallën e mbështetjes së Britanisë së Madhe për rezistencën shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore, përmes operacioneve të **SOE-së**.

Nga grupi i parë prej **50 britanikësh** që zbritën në Shqipëri, **16** mbetën të vrarë, ndërsa **17 të mbijetuar** u dekoruan për trimërinë dhe shërbimin e tyre. Në periudhën e veprimtarisë së **SOE-së** në Shqipëri, dhanë jetën gjithsej **53 pjesëtarë** të këtyre forcave speciale britanike.

Autori e nis rrëfimin e tij dramatik me pjesë nga vepra e **Ismail Kadaresë, "Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur"**. Historia e mbetjeve mortore të këtyre të rënëve britanikë është tejet e dhimbshme. Ata kurrsesi nuk mund të vlerësohen si armiq pushtues të Shqipërisë; përkundrazi, ata erdhën si **çlirimtarë** dhe dhanë jetën

për të nxitur e ndihmuar popullin shqiptar në përpjekjen e tij për t'u liruar nga fashizmi dhe nazizmi.

SOE u shpërnda zyrtarisht më **15 janar 1946**. Pas luftës, britanikët ndërmorën përpjekje të mëdha për të mbledhur eshtrat e të rënëve të tyre, një mision që u zhvillua me të njëjtën përkujdesje si në Shqipëri, ashtu edhe kudo tjetër në botë.

Regjimi i **Enver Hoxhës**, i cili fillimisht kishte marrë një kurs pro–jugosllav dhe më pas pro–sovjetik, i solli shumë pengesa përpjekjeve të britanikëve për të marrë eshtrat e djemve dhe vajzave të tyre të rënë në Shqipëri.

Autori tregon se, pavarësisht këtyre pengesave nga qeveria, një oficer britanik i quajtur **MacIntosh** gjeti një mbështetje të jashtëzakonshme tek populli shqiptar, i cili u tregua bujar dhe mikpritës. Në **shkurt të vitit 1946**, ai udhëtoi fshat më fshat dhe breg më breg në kërkim të tyre, derisa arriti të mblidhte një pjesë të eshtrave të të rënëve britanikë.

Fatkeqësisht, MacIntosh u përzua nga qeveria shqiptare si "reaksionar dhe armik i popullit shqiptar", duke e lënë misionin e tij të pambaruar. Por më e keqja

ende nuk kishte ndodhur: qeveria britanike ia besoi më pas **Ambasadës Franceze** në Tiranë detyrën për kujdesin dhe mbledhjen e eshtrave. Në vitin **1950**, një atashe francez vizitoi varrezat e britanikëve në Shqipëri...

Ai nuk gjeti asnjë gjurmë të tyre. Qeveria e Enver Hoxhës i kishte fshehur eshtrat dhe nuk lejoi që, qoftë edhe të vdekur, ata të preheshin në paqe në vendin ku kishin rënë.

E drejta e këtyre njerëzve për t'u prehur në një vend të qetë u "fitua" vetëm pas rrëzimit të diktaturës komuniste në Shqipëri. Vetëm atëherë eshtrat e tyre u mblodhën dhe u vendosën me nderime në një varrezë të posaçme në **Parkun e Tiranës**, aty ku sot gjendet **Memoriali i të Rënëve Britanikë**.

IN MEMORIAM

Më **11 nëntor 2012**, Ambasadori Britanik në Tiranë, Sh.T. z. **Nicholas Cannon**, së bashku me Kryeministrin e asaj kohe, Dr. **Sali Berisha**, organizuan një shërbesë përkujtimore në **varrezat e britanikëve** në Parkun e Tiranës.

Aty përkujtohen **53 të rënë**, por vetëm **46 prej tyre** kanë pllakat e varreve me emrat mbi kokë, ndërsa të tjerët mbeten ende pa një shenjë identifikuese.

Shqipëria u ka një borxh nderi këtyre të rënëve për kontributin e tyre në çlirimin e vendit tonë.

Pas kthimit në atdhe, veteranët e **SOE-së** që kishin shërbyer në Shqipëri, iu përkushtuan vendit të tyre në fusha të ndryshme të jetës publike. Shumë prej tyre u bënë njerëz të shquar dhe politikanë me ndikim.

Le të përmendim disa prej tyre:

Harold Julian Amery, Baron Amery of Lustleigh (1919–1996), ishte një politikan konservator britanik, i cili për tri dekada shërbeu si një figurë drejtuese e Partisë Konservatore dhe për **42 vjet** ishte anëtar i parlamentit britanik.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, ai shërbeu si **oficer ndërlidhës i SOE-së** për lëvizjen e rezistencës antifashiste shqiptare në vitet **1943–1944**, si pjesë e grupit të njohur me emrin **“Tre Muskëtjerët”**, së bashku me majorin **David Smiley** dhe kolonelin **Neil McLean**.

John Anthony Quayle (1913–1989), një nga aktorët më të mëdhenj të teatrit anglez, gjatë Luftës së Dytë Botërore shërbeu si oficer i **shërbimit sekret britanik (SOE)**. Në vitin **1943** ai mbërriti në **Tragjas, Shqipëri**, ku mori pjesë në misionet e aleatëve pranë forcave të rezistencës.

Pas luftës, Quayle iu përkushtua aktrimit dhe arriti të bëhej një figurë madhore e skenës britanike. Ai drejtoi **Teatrin Memorial të Shekspirit** dhe hodhi themelet e krijimit të **Kompanisë Mbretërore të Teatrit Shekspirian (Royal Shakespeare Company)**. Ka interpretuar role të mëdha klasike si **Falstafi, Otello, Henri VIII**, si dhe ka ndarë skenën me emra të mëdhenj si **Laurence Olivier**. Karriera e tij përfshin një galeri të pafund rolesh në teatër dhe film.

Për shqiptarët, Quayle mbetet një figurë e dashur jo vetëm sepse shërbeu në vendin tonë gjatë luftës, por edhe sepse ishte një **anëtar aktiv dhe i përhershëm i Shoqatës Anglo-Shqiptare (AAA)**, duke mbajtur gjallë lidhjet kulturore midis Shqipërisë dhe Britanisë së Madhe.

Kolonel David Smiley (1916–2009) ishte një oficer i shërbimeve të fshehta britanike. Gjatë Luftës së Dytë Botërore ai mori pjesë në operacione në **Palestinë, Irak, Persi dhe Siri**, si dhe shërbeu me **SOE-në** në **Shqipëri** dhe në **Tailandë**. Përvojën e tij në Shqipëri e përshkroi në librin e njohur *"Albanian Assignment"*, i cili mbetet një dëshmi e vyer për veprimtarinë e britanikëve në vendin tonë gjatë luftës.

Margaret Hasluck (1885–1948), një intelektuale dhe albanologe e njohur skoceze, gjithashtu shërbeu në radhët e **SOE-së** në Shqipëri. Pas luftës, pas ekzekutimit nga komunistët të mikut të saj të ngushtë shqiptar, **Lef Nosi**, ajo u trondit thellë, u sëmur rëndë dhe vdiq në varfëri në **Dublin** në vitin **1948**. Në ditët e fundit të jetës, miqtë e saj të SOE-së e ndihmuan në mënyrë anonime, duke treguar respekt dhe mirënjohje për sakrificat e saj.

Neil "Billy" McLean (1918–1986), në vitin **1943** iu bashkua misioneve të **SOE-së** dhe zbriti në territoret e okupuara të Shqipërisë. Në **prill 1944**, McLean, së bashku me një ekip të vogël të njohur si **"Tre Muskëtjerët"**, ku bënin pjesë gjithashtu **David Smiley**

dhe **Julian Amery**, u përpoqën të pajtonin grupet e ndryshme politike shqiptare për t'i bashkuar në luftën kundër nazistëve, por përpjekja e tyre nuk pati sukses.

Pas luftës, McLean u përfshi në politikën britanike, ku shërbeu për **dhjetë vjet** si anëtar i Parlamentit.

STATUJA E HEROINËS SË SOE-SË NË LONDËR

Në Londër gjendet një statujë bronxi që i kushtohet anëtarëve të **SOE-së**. Sa herë që kaloja buzë lumit

Tamiz, në rrugën që të çon nga **Ura Lambeth** drejt **London Eye (Syri i Londrës)**, ndalesha përpara këtij busti.

Ajo është përmendorja e një gruaje me një vështrim të mprehtë, me një portret të bukur dhe forma të rregullta, që shikon larg me vendosmëri. Në këtë vepër nuk gjen asnjë shformim tipik të artit modern; përkundrazi, ajo ruan përmasat dhe raportet natyrale të një skulpture klasike, e skalitur mbi bazën e parimeve të estetikës së realizmit.

Në këtë vepër nuk ka as glorifikim dhe as shtesa tiparesh që ta kthejnë figurën në një **super-njeri, super-heroinë apo super-grua**. Përkundrazi, në të gjen thjeshtësinë dhe natyralitetin që e bëjnë skulpturën të flasë vetë përmes qëndrimit dhe shprehjes së saj.

Ajo mishëron pikërisht ato parime që skulptori i madh francez **Auguste Rodin** u mësonte studentëve të tij lidhur me raportin formë–përmbajtje në artin skulpturor. Dhe pse jo, të kujton edhe mjeshtërinë e skulptorit tonë kombëtar, **Odhise Paskali**, i cili po ashtu e ndërtoi artin e tij mbi themelet e realizmit dhe përmasës njerëzore të figurës.

Jam ndalur shumë herë përpara atij busti. Madje, sa herë që kam kaluar pranë tij, e kam fotografuar. Në një rast, një prej këtyre fotografive e kam përdorur si ilustrim në librin tim *"Realitetet Shqiptaro–Britanike"*, pikërisht në pjesën ku flitet për grupin britanik të njohur me emrin **Special Operations Executive (SOE)**.

Ky portret iu është kushtuar pikërisht atyre njerëzve të guximshëm që arritën të depërtonin në prapavijat e armikut nazist anembanë Evropës.
Sa herë që i kaloja pranë, ndalesha me respekt përpara saj, sepse ajo përfaqëson ata që shpëtuan botën nga katastrofa.

Një prej ditëve të shëtitjeve të mia buzë lumit **Tamiz**, pata rastin të takoj autorin e asaj skulpture. Ai ishte **Ivan Saxton** dhe po e pastronte me duart e veta bustin. Më tregoi sesi e kishte krijuar atë vepër, duke pasur si model pikërisht një anëtare të **SOE-së**, e cila kishte jetuar dikur në atë zonë të Londrës, aty ku gjendet sot monumenti.

> **"Ajo heroinë më ka frymëzuar për këtë vepër dhe po ajo më ka pozuar,"** – më tha Ivani. – **"Në tiparet e saj pashë aq shumë elemente që mishëronin**

një përfaqësuese të kësaj organizate. U përpoqa t'i shprehja të gjitha këto në një portret."

Operativët Specialë Ekzekutivë (SOE) janë të vetmit ushtarë të huaj, në historinë e gjatë të Shqipërisë, që erdhën jo si pushtues, por si çlirimtarë.

1939 + 1945
NE KUJTIM TE USHTARAKEVE
ANGLEZE TE RENE
NE SHQIPERI GJATE LUFTES
Left side of the roac
THE MEN IN WHOSE MEMORY
THESE HEADSTONES
HAVE BEEN ERECTED
GAVE THEIR LIVES IN ALBANIA
AND ARE BURIED
SHALL NOT
OUT
DHOMA E BRITANIKE E TREGE